



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GRUPI KËSHILLIMOR I STABILITETIT FINANCIAR

Tiranë, më 21.07.2020

NJOFTIM PËR SHTYP

Mbi mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar,

21 korrik 2020

Në datën 21 korrik 2020, u zhvillua mbledhja e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Në këtë mbledhje që u zhvillua *online* morën pjesë, në distancë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve.

Programi i mbledhjes përfshinte vlerësimet e secilit autoritet financiar, mbi zhvillimet në institucionet dhe tregjet që mbikëqyrin nën ndikimin e pandemisë së koronavirusit ‘Sars-Cov-2’ (më tej, ‘pandemia’). Fokusi ishte tek vlerësimi i gjendjes së sistemit financiar, i rreziqeve që sjell ndikimi i pandemisë, i rezistencës së institucioneve financiare dhe i masave që janë ndërmarrë për të zbutur rreziqet dhe forcuar rezistencën e sistemit financiar.

Pasi u njohën me prezantimet e përgatitura dhe diskutuan rreth tyre, pjesëmarrësit konkluduan në vlerësimet e mëposhtme:

- 1) *Sistemi financiar është i qëndrueshëm dhe situata financiare mbetet e mirë.* Ky vlerësim reflekton zhvillimet pozitive në treguesit e sistemit financiar përpara shfaqjes së pandemisë, reagimin e institucioneve financiare për të kontrolluar rreziqet operationale gjatë këtyre muajve të zhvillimit të saj dhe efektin e masave të marra nga autoritetet për të mbështetur veprimtarinë financiare. Më konkretisht, për sektorin bankar treguesit e kapitalizimit dhe të likuiditetit të veprimtarisë paraqiten në nivele mjaft të mira, ndjeshëm mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullativ. Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është pranë nivelit 19% ndërsa raporti i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtera është pranë nivelit 50%. Në tregun e Fondeve të Investimit, treguesit e likuiditetit paraqiten mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullativ. Edhe në tregun e sigurimeve, shoqëritë e sigurimit kanë ruajtur nivelet e përshtatshme të provigjioneve teknike.
- 2) *Ndikimi i pandemisë po vijon të ndjehet në veprimtarinë e sistemit financiar.* Zbatimi i masave shtetërore për ruajtjen e shëndetit publik në periudhën mars-prill të këtij viti, është shoqëruar me kufizime në veprimtarinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë dhe aktivitetin e tregjeve financiare. Si rezultat, është vënë re ngadalësim i aktivitetit të ndërmjetësimit financiar të

sektorit bankar, rënie e primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve dhe ndalim i rritjes së aktiveve neto në veprimtarinë e fondeve të investimit. Megjithë rifillimin gradual të aktivitetit ekonomik që prej muajit maj, ecuria e mëtejshme e tij kushtëzohet plotësisht nga ecuria e pandemisë dhe efektet e saj mbi konsumin dhe investimet në vend, si edhe zhvillimet ekonomike ndërkombëtare.

- 3) *Autoritet publike kanë mbështetur veprimtarinë e operatorëve ekonomikë dhe të sistemit financiar, për zbutjen e rreziqeve dhe forcimin e rezistencës financiare.* Për këtë qëllim, Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka miratuar paketat e ndihmës dhe të garancisë financiare për punonjësit e sektorit privat dhe të vetpunësuarit, në veprimtari ekonomike të kufizuara nga masat shtetërore për ruajtjen e shëndetit publik, dhe për mbështetjen e sipërmarrjeve me kapital qarkullues. Gjithashtu, në kushtet e rënies së të ardhurave të buxhetit të shtetit, janë siguruar burimet e financimit kryesisht nëpërmjet huamarrjes nga tregjet e huaja dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare. Këto dhe elementë të tjerë të nevojshëm për ruajtjen e stimulit fiskal në zhvillimin e ekonomisë, janë reflektuar në rishikimin që po i bëhet buxhetit të shtetit. Masat konsiderojnë jo vetëm ndikimin aktual të pandemisë mbi aktivitetin ekonomik por edhe nevojën që të ruhen hapësirat dhe ekuilibrat në treguesit fiskalë në rast të vijimit të zhvillimeve të pafavorshme. Për tregun financiar dhe veprimtarinë bankare, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë disa masa si autoritet monetar dhe mbikëqyrës. Lehtësimi i mëtejshëm i politikës monetare dhe injektimi i pakufizuar i likuiditetit në tregun ndërbankar, kanë ruajtur nivelet e ulëta të normave të interesit dhe stimulim për kredidhënie. Në partneritet me institucionet e huaja homologe, janë siguruar instrumentet për mbështetjen e tregut me likuiditet në valutë. Paralelisht, veprimet ligjore dhe ndryshimet rregullative iu kanë dhënë kohën dhe mundësinë huamarrësve të prekur nga efektet e pandemisë dhe bankave, që të ristrukturojnë ekspozimet përkatëse me qëllim që, aty ku është e mundur, të ruhet aftësia paguese e huamarrësit dhe cilësia e kredisë. Megjithëse këto masa do të zbutin rënien e cilësisë së kredisë në sektorin bankar, efekti i pandemisë mbi këtë tregues pritet të jetë i ndjeshëm. Si rezultat, kostot e bankave që lidhen me krijimin e fondeve rezervë për rrezikun e kredisë do të rriten dhe rezultati financiar mund të bjerë. Në bazë të këtij vlerësimi, Banka e Shqipërisë iu ka kërkuar bankave të pezullojnë shpërndarjen e fitimit (si dividend), duke synuar që ndikimi i rënies së mundshme të rezultatit financiar mbi treguesit e kapitalizimit të veprimtarisë të zbutet. Komunikimi me bankat është përforcuar dhe kërkesat për raportim janë bërë më specifike dhe më të shpeshta. Masa të ngjashme mbikëqyrëse, ka ndërmarrë edhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për subjektet financiare jobankare që rregullon. Në këtë drejtim, janë rritur kërkesat për raportim të shpeshtë të gjendjes së likuiditetit për këto subjekte, dhe është pezulluar shpërndarja e fitimit për shoqeritë e sigurimit. Gjithashtu, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka rritur vëmendjen mbikëqyrëse në drejtim të përshtatshmërisë së planeve të vijimit të veprimtarisë për subjektet më relevante që mbikëqyr. Agjencia e Sigurimit të Depozitave, plotëson kuadrin institucional të autoriteteve publike që mbështetin qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Ajo ka vijuar të administrojë në mënyrën më të përshtatshme

fondin e kompensimit të depozitave, të eksplorojë mundësinë e zgjerimit të tij në partneritet me institucione financiare ndërkombetare, si edhe të përsosë kuadrin e procedurave të saj. Në kushtet aktuale, vlerësohet se masat e mësipërme të ndërmarra nga autoritetet kanë përmirësuar kapacitetet e sistemit financiar për të përballuar goditjen që pësoi ekonomia nga pandemia.

4) *Sidoqoftë, rreziqet për aktivitetin ekonomik të vendit dhe sistemin financiar që vijnë nga pandemia mbeten të pranishme dhe ecuria e këtyre rreziqeve mbetet e pasigurt. Si rezultat është e nevojshme që industria financiare dhe autoritetet përkatëse rregullative të harmonizojnë veprimet me qëllim që:*

- a. informacioni i cili mblidhet dhe analizohet për veprimtarinë e sistemit financiar, dhe vecanërisht për drejtimit e saj që ndikohen më shumë nga pandemia, të jetë sa më i plotë, frekuent dhe në kohën e duhur, me qëllim që t'i shërbejë në mënyrë më efektive vendimmarrjes;
- b. institucionet financiare të fuqizojnë kapacitet analitike si instrument i domosdoshëm për të vlerësuar rezistencën e tyre financiare ndaj zhvillimeve ekonomike të pafavorshme, duke përfshirë skenarë specifikë dhe të shtrirë në kohë. Këto analiza duhet të jenë pjesë e vlerësimeve të rregullta dhe të shpeshta nga strukturat drejtuese, dhe duhet të plotësojnë vendimmarrjen e tyre paraprake për fuqizimin e pozicioneve të kapitalit dhe të likuiditetit, në rast nevoje;
- c. të gjendet një ekuilibër i drejtë midis nevojës për të mbështetur operatorët ekonomikë që kanë nevojë për financim në këtë periudhë dhe kujdesit të shtuar për rrezikun e këtij financimi. Garancitë e ofruara nga Qeveria për huadhënie nga sektori bankar, ofrojnë një instrument që ndihmon në arritjen e këtij objekti. Është e dëshirueshme që përdorimi i këtyre garancive të jetë më i shpejtë duke i dhënë përparësi ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla.

5) *Autoritetet publike do të vijojnë të mbështesin veprimtarinë e sistemit financiar, me masat e nevojshme, në përgjigje të zhvillimeve që kushtëzohen nga ecuria e pandemisë. Për këtë qëllim, autoritetet do të forcojnë komunikimin dhe do të bashkëveprojnë duke u udhëhequr nga këto parime:*

- a. *së pari, ruajtja e qëndrueshmërisë së sistemit financiar.* Në këtë drejtim, autoritetet do t'iu kërkojnë institucioneve financiare që mbikëqyrin të ruajnë masat e nevojshme për të mbrojtur shëndetin e personelit, për të garantuar mirëfunksionimin e operacioneve dhe sistemeve kritike të institucionit, si edhe për të ruajtur treguesit e kapitalizimit dhe të likuiditetit të veprimtarisë. Nga ana e tyre, autoritetet do të vijojnë të verifikojnë përshtatshmërinë e proceseve, të procedurave dhe të burimeve financiare e njerëzore, në mënyrë që ushtrimi i rolit të tyre për mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare dhe të tregjeve, të kryhet në mënyrë sa më efektive; dhe
- b. *së dyti, përballimi i sfidave me fleksibilitet dhe transparencë.* Në këtë drejtim, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe rregullative dhe duke

konsideruar më parë parimin e mësipërm të ruajtjes së qëndrueshmërisë, do të monitorohen zhvillimet në sistemin financiar dhe në rast nevoje, në linjë me interpretimet e institucioneve përkatëse ndërkombetare, do të synohet të zbutet efekti prociklik në kërkesat rregullative. Kjo do të mundësohet në ato raste kur mënyra e rikthimit në kërkesat normale rregullative, mbetet e qartë dhe e realizueshme. Paralelisht, institucioneve financiare në vend do t'iu kërkohej të ruajnë standardin më të lartë të transparencës në drejtim të raportimit të pasqyrave financiare dhe të treguesve prudencialë.

Në vijim, të pranishmit komunikuan mbi çështje të tjera me interes të përbashkët. Me mbylljen e diskutimeve në mbledhje sipas programit, drejtuesit e institucioneve pjesëmarrëse miratuan këtë njoftim për shtyp dhe autorizuan publikimin e tij.